

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit BSc në Inxhinieri Ndërtimi**

**në Universitetin Privat EPOKA**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm: **Prof. Dr. Luljeta Bozo**



Qershor - Korrik 2017

## **DRAFT- RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Për Programin e studimit BSc Inxhinieri Ndërtimi**

<b>Tabela e të dhënave për programin e studimit</b>		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Epoka
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Arkitektures dhe Inxhinierisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit Urdhëri i riorganizimit	VKM Nr. 281, datë 12.03.2008 Urdhër Nr. 213, datë 25.05.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 260, datë 07.06.2011 (*)
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2012-2013
17	Numri total i studentëve për program studimi	70

*\*) Sipas Urdhërit të Akreditimit Nr. 260, datë 07.06.2011, ky program studimi është akredituar si Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, me kohëzgjatje normale 4 vite. Është hera e parë që ky program studimi i nënshtrohet procesit të akreditimit pas riorganizimit të tij me Urdhër Nr. 213, datë 25.05.2012, si Bsc në Inxhinieri Ndërtimi me kohëzgjatje normale 3 vite.*

#### **Shënim:**

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

## **HYRJE**

### **Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Bsc në Inxhinieri Ndërtimi**

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i Universitetit "Epoka" ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit është pjesë përbërëse e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë.

Në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi, programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi me një kohëzgjatje normale të studimeve prej katër vitesh akademike (240 ECTS) është licencuar me Vendim Nr. 281, datë 12.03.2008, të Këshillit të Ministrave. Me Urdhr Nr. 260, datë 07.06.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Institucioni dhe programi i studimit është akredituar.

Me Vendim Nr. 2, datë 28.09.2011, të Senatit Akademik u bë riorganizimi i programeve të studimit të ciklit të parë Bachelor nga programe studimi me një kohëzgjatje normale të studimeve katër vite akademike (240 ECTS) në programe studimi me kohëzgjatje normale të studimeve tre vite akademike (180 ECTS), në zbatim të Ligjit Nr. 10307, datë 22.07.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Në bazë të Urdhrit Nr. 213, datë 25.05.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, programi Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi me një kohëzgjatje normale të studimeve katër vite akademike (240 ECTS), u riorganizua në program Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi me një kohëzgjatje normale të studimeve tre vite akademike, (180 ECTS)

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Dr. Luljeta Bozo

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL dhe miratimi i përbërjes së tij në Bordin e Akreditimit, me Urdhër nr. 45, datë 30.05.2017. Nga ASCAL mori pjesë specialistja Znj. Renata Qatipi.

Institucioni "Universiteti Privat EPOKA" me shkresë Nr. 020/13 Prot, datë 12.07.2017 "Komente në lidhje me draft-raportin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit "Bachelor" në "Inxhinieri Ndërtimi", ka sjellë në ASCAL komentet lidhur me Draft RVJ, të cilat u morën pjesërisht në konsideratë nga eksperti i vlerësimit dhe ndryshimet u pasqyruan në Raport.

### **ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KËSHILLI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË**

#### **I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit**

- a) Harmonizim i krediteve Amerikane me ato Europiane
- b) Kompletimi i Biblotekës
- c) Të stimulohet puna individuale e studentëve
- d) Te profilizohet me qarte stafi

e) Për kordinimin më të mirë të periudhës se profesorëve vizitues

## **II. Plotësimi i tyre nga Institucioni**

- a) Rekomandimin a) institucioni e ka plotësuar totalisht
- b) Rekomandimin b) institucioni e ka plotësuar mjaft mire
- c) Rekomandimin c) institucioni e ka plotësuar shumë mirë
- d) Rekomandimin d) institucioni ka plotësuar mjaft mire
- e) Rekomandimin e) institucioni ka plotësuar mjaft mire

# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkimore

Misioni i këtij programi studimi është të përgatiti inxhinierë profesionist dhe drejtues të aftë në profesionin e tyre. Më duket se me 3 vjet studimi, dhe diplomën që merr në fund të këtij programi studimesh studenti nuk besoj se do të mund të plotësojë kushtet e mësipërme. Misioni mund të ishte që ky program përbën bazamentin për nivelin master, i cili krijon mundësi për t'u bërë inxhinier profesionist dhe drejtues i aftë.

Po kështu qëllimi i programit është me shumë pretendime, pasi mendoj se me 3 vjet përgatitje specialisti "Bachelor ne Inxhinieri Ndërtim" nuk ka mundësi të konceptojë, të planifikojw, të projektojë vepra të ndryshme inxhinierike, dhe të zgjidhw probleme teknike me njohuri të sofistikuar bashkëkohore.

Mendoj se duhet bërë e qartë se në cilat fusha të ndërtimit, dhe në cilat pozicione mund të punojë specialisti "Bachelor në Inxhinieri Ndërtim", pasi pretendimi për përgatitjen me anën e këtij programi të lidhshpimit në rang lokal shtetëror, kombëtar e ndërkombëtar për zgjidhjen e problemeve komplekse inxhinierike me të cilat përballet sot shoqëria është disi i tepruar.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programi mësimor në përgjithësi është hartuar mirë.
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	Mendoj se në vitin e parë 11 ECTS janë shumë për zhvillimin e aftësive në leximin dhe shkrimin e gjuhës angleze. Ndoshta do të mjaftonin 8 ECTS dhe 3 ECTS t'i jepeshin lëndës "Konstruksione arkitektonike", për të cilat studenti nuk merr asnjë njohuri.
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Objektivat e programeve të shprehura në sylabuset e lëndëve të veçanta janë të qarta për të përgatitur specialistin "Bachelor në Inxhinierin Ndërtim".
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut, por nuk mund të mbulojë plotësisht të gjitha fushat e ndërtimit për tre vjet studimi.
	Mendoj se që në objektivat duhet të dali qartë se ku mund të punojë, dhe në cilat procese specialisti "Bachelor në Inxhinierinë e Ndërtimit". Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut por nuk mund të mbulojnë plotësisht të gjitha fushat për 3 vjet.

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.



	Mendoj që në objektivat duhet të dali qartë se ku mund të punojë dhe në cilat procese specialist Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi.
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Strategjia e zhvillimit të institucionit është rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe e kërkimit shkencor, dhe programet janë përshtatur me këtë strategji.</p> <p>Programet e ciklit të parë japin një bazë të mirë teorike për shkencat teorike fundamentale.</p> <p>Programet e ciklit të parë arrijnë nëpërmjet lëndëve aplikative të formojnë në një farë mase shprehitë praktike të studentit, por dhënia e gjithë lëndëve teknike në një vit (viti i III) është ngarkesë e madhe për studentin. Ndoshta mund të shihet mundësia e zhvendosjes, ose e shkëmbimit të një lënde të vitit të tretë në vitin e dytë.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Në bazë të diskutimeve institucioni po përgatitet për strategjinë e shfrytëzimit të pasurive ujore dhe të materialeve. Mendoj se ka dhe strategji të tjera afatgjatë të zhvillimit ekonomik të vendit si energjitika, zonat rurale, turizmi, zonat minerare etj.</p> <p>Institucioni kryen një studim për tregun e punës në drejtim të :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Punësimit të studentëve dhe këtu ka patur sukses</li> <li>Kërkesave të punëdhënësve nëpërmjet kontakteve me firmat e ndryshme ndërtimore</li> <li>Numëri i studentëve shqiptarë dhe nga rajoni tani është rreth 40 dhe mendohet se ai do të vërtitet rreth këtij numuri</li> <li>Për numurin e të regjistruarve në programe simotra nuk kishte informacion.</li> </ol>
<b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programet synojnë të ruajnë vlerat kulturore kombëtare. Ndoshta kjo duhet të sqarohet nëpërmjet projekteve në disa lëndë.</p>
<b>Konkluzione të GVJ:</b>	
<p>Programi Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është në përputhje me misionin dhe strategjinë e Universitetit Epoka, si dhe strategjinë e zhvillimit ekonomik kombëtar. Ai i pajis studentët me njohuritë bazë teorike, teorike-teknike si dhe me njohuri aplikative në përputhje me kërkesat e tregut. Mjaft mirë është organizuar praktika verore, e cila i shërben jo vetëm studentit, lidhjeve të</p>	

Universitetit me bazën, por dhe punësimit të ardhshëm të studentëve.

### **REKOMANDIM**

- 1- Të shihet mundësia e vendosjes së lëndës Konstruksione Arkitektonike me 3 ECTS, duke marrë kredite nga Gjuha Angleze që ka 11 ECTS
- 2- Të ketë një dokument ku shkruhen qartë fushat ku mund të punojë, dhe në ç'farë pozicionesh mund të punojë specialisti "Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi".
- 3- Të shihet mundësia e rishpërndarjes së ngarkesës së vitit të tretë, pasi ajo është shumë e madhe dhe krijon vështirësi në asimilimin e lëndëve si Konstruksione b/a. Gjeoteknikë, Themele, Rrugë etj. nga ana e studentëve.

## **2. Struktura akademike e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë**

### **Pjesa përshkrimore**

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka një strukturë të qartë e të përbërë nga Dekani, Koordinatori i fakultetit, Këshilli i fakultetit, Këshilli administrativ dhe këshilli i profesorëve.

Vetë fakulteti përbëhet nga 3 departamente:

- Departamenti i Arkitekturës,
- Departamenti i Inxhinierisë së ndërtimit dhe
- Departamenti i Inxhinierisë kompjuterike.

Nga studimi i raportit të vlerësimit të brendshëm, dhe nga vizita në vend kam këto mendime:

Dekani ka shumë detyra, disa prej tyre si p.sh. pikat 13, 15, 16 mendoj se mund të jenë të shfave të departamenteve.

Këshilli i fakultetit, si organ kolegjal vendimarrës për mësimdhënien, kërkimin e publikimet i ka detyrat e qarta.

Këshilli administrativ, si organ kolegjal vendimarrës për përdorimin e burimeve njerëzore dhe materialeve, i ka detyrat e qarta, por vërej se anëtarët e tij janë të njëjtët me ata të Këshillit të fakultetit, dhe duket sikur kanë të njëjtat kompetenca dhe duket se rizgjedh veten.

Këshilli i profesorëve i ka detyrat të qarta dhe ai është i kompletuar sipas standardit.

Departamenti i Inxhinierisë Ndërtimit, si njësi bazë mësimore e kërkimore i ka detyrat e qarta e të plota. Mendoj se shefi i departamentit duhet të zgjidhet në një farë mënyre dhe jo të emërohet. Nga ana tjetër struktura didaktike duhet të sqarohet se ç'farë masterash shkencorë e profesional përgatit ky departament.

Po kështu nuk del e qartë si strukturë "Këshilli shkencor i programit". Staf i departamentit i përbërë nga pedagogë efektivë (PAE), me kontratë (PAK) dhe personeli administrativ, është i mjaftueshëm për të përballuar ngarkesën mësimore e kërkimore të departamentit. Procedura e rekrutimit të pedagogëve të rinj më duket e drejtë, dhe kur ata rekrutohen, me

ta lidhet fillimisht një kontratë pune 1 vjeçare. Gjithë dokumentacioni që pasqyron këtë pjesë të aktivitetit të IAL është i plotë.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Skema organizative e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë është shumë e qartë. Dekani ka shumë detyra, mendoj se disa prej tyre mund t'i kalojnë shefave të departamenteve (pika 13, 15, 16).

Këshilli i Fakultetit i ka ndarë detyrat në mënyrë shumë të qartë po ashtu dhe këshilli administrativ, por janë pothuajse të njëjtët persona si tek Këshilli i Fakultetit dhe duket sikur rizgjedh vehten (Këshilli i Fakultetit zgjedh Këshillin Administrativ).

Këshilli i Profesorëve është në rregull dhe me detyra të qarta. Shefi i departamentit i ka detyrat të caktuara shumë mirë dhe shumë të qarta. Struktura didaktike është mjaftueshëm mirë: 18 pedagogë të brendshëm e të jashtëm dhe 4 persona administrativ.

Këshilli Shkencor i programit të studimit nuk del qartë në strukturë, dokumentacioni përkatës i plotë, kontratat 1 vjeçare.

#### Organizimi hierarkik i Fakultetit:

Organizimi hierarkik i Fakultetit është një sistem vertikal, ku në krye të tij qëndron dekani. Ky sistem shprehet qartë jo vetëm në organigramën e paraqitur, por dhe në detajimet e kompetencave të të gjitha hallkave që e përbëjnë atë. Konstatohet se ky sistem funksionon mirë qoftë në drejtim të organizimit të punës, ashtu dhe të llogaridhënies. Mendoj se në gjithë këtë sistem dekani është shumë i ngarkuar me kompetenca, disa prej të cilave mund t'ja delegojë shefave të departamenteve.

#### Struktura akademike e Fakultetit

Struktura akademike e Fakultetit përbëhet nga Dekani, Koordinator i Fakultetit, Këshilli i Fakultetit, Këshilli Administrativ, Këshilli i Profesorëve. Fakulteti përbëhet nga tre Departamente.

#### Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni përkatës marrë nga vizita në Institucion janë : Organigrama e Fakultetit, Këshilli i Fakultetit i përbërë nga 6 persona, Këshilli Administrativ i përbërë nga 6 persona (të njëjtët me ata të këshillit të Fakultetit), Këshilli i Profesorëve i përbërë nga 7 profesorë nga të cilët 3 të jashtëm, tre departamentet me emrat e dekanëve respektiv, organigrama e strukturës didaktike për çdo departament dhe program studimi, kopje të kontratës së punës, numrin e personelit akademik për Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit duke i specifikuar në PAE, PAK me titujt e gradat që disponojnë, Këshilli Shkencor Programit të studimeve dhe koordinatori i tij i përbërë nga 3 veta. Dokumentacioni i siguruar nga Zyra e Burimeve Njerëzore si dhe vizita e kryer në Institucion na lejon të konfirmojmë se nuk ka ndryshime në deklaratimet e kryera dhe se gjithë dokumentacioni është në përputhje me standartet



### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

Në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit aktivizohet një personel prej 18 pedagogësh nga të cilët 14 efektiv (PAE) dhe 6 me kontratë (PAK), si dhe personel administrativ prej 2 personash. Raportet mes personelit akademik me kontratë dhe atij efektiv janë optimale (70 % janë efektiv). Po kështu gati 50% e personelit akademik është me tituj e grada. Një e dhënë pozitive është mosha e personelit akademik ku zotëron mosha nën 45 vjeç që ka pjekurinë e duhur dhe është shumë aktive si në mësimdhënie dhe në punën kërkimore.

Personeli akademik mban lidhje të vazhdueshme me firmat e ndërtimit qoftë për të siguruar vëndin për praktikantët e studentëve, qoftë për të marrë problematika për zgjidhje, qoftë për kualifikimin e praktikanëve.

Për rekrutimin e pedagogëve të rinj ekzistojnë procedura ligjore, transparente, me kërkesa të tilla që bëjnë të mundur marrjen e një stafi të ri mjaft cilësor, i cili në vazhdimësi trajnohet nga Departamenti për t'u kualifikuar sa më shpejt në mësimdhënie dhe për t'u futur sa më shpejt në procesin kërkimor-shkencor.

Sipas seksit në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit kemi një raport femra në lidhje me numrin e përgjithshëm 4/20 ose 1:5, i cili mendoj se mund të përmirësohet. Çdo person (staf akademik apo administrativ) në kontratën e tij të punës njihet hollësisht me detyrimet, detyrat dhe të drejtat e tij.

Nga vizita në Institucion konstatojmë se gjithë dokumentacioni lidhur me personelin efektiv, e me kontratë (mosha, titulli, grada, kualifikimet etj) ishte i plotë.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

Për programin e studimit Bachelor ne Inxhinieri Ndërtimi egziston nje strukturë didaktike që është Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.

Numri i personelit akademik efektiv PAE eshte 18 atij me kontrate PAK eshte 4 dhe me titujt dhe gradat janë gati 50%. (Shikoni tabelen bashkangjitur)

- Të dhënat sipas seksit

Sipas seksit në këtë departament aktivizohen 4 të gjinisë femërore dhe raporti është 4/20

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Sipas moshes (shih tabelen bashkangjitur) mbizotëron mosha nën 45 vjec.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontrata e punës përmban detyrimet, detyrat dhe të drejtat, e cdo personi rekrutohet. Ajo është mjaft e detajuar dhe e plotë.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës është me diplome Bsc dhe stafi administrativ është me diplome MSc.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga vizita në institucion ne u njohëm me gjithë dokumentacionin që i takon kësaj pike dhe konstatojmë se në to nuk ka ndryshime dhe ata i përmbushin standartet që lidhen me këta tregues.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardet/kriteret</b>	<b>Përmbushja e standardeve</b>
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Rekrutimi i personelit kryhet sipas procedurave ligjore në përputhje me statutin dhe rregulloren. Personeli akademik efektiv për realizimin e ciklit të parë është 14 persona dhe përbën 70% të personelit të angazhuar (14/20).</p> <p>Për vlerësimin e personelit ndiqen procedura ligjore, transparente si vlerësimi nga studentët dhe nga shefat e departamenteve.</p> <p>Mendoj se edhe vizitat reciproke të pedagogëve tek njeri-tjetri do të ishte një mënyrë vlerësimi dhe njëkohësisht shkëmbim përvoja. Institucioni ka gjithë dokumentacionin lidhur me rekrutimin e personelit (u panë raportet nga komisionet e ngritura për këtë qëllim).</p>
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor", ose titullin akademik "Docent".</p>	<p>Pas verifikimit konstatojmë se Institucioni disponon të dhëna të hollësishme për anëtarët e personelit akademik. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për çdo simestër, si dhe listën e personelit ndihmës.</p> <p>Institucioni, sipas nevojave për të mbuluar ngarkesën mësimore publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Titullarët e lëndëve kanë së paku gradën "Doktor i Shkencave", ose titullin "Docent".</p>
<b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Institucioni ka laborator dhe nje teknik laborator. Institucioni angazhon personat e duhur për punët administrative (sekretaria).</p> <p>Është një përvojë pozitive caktimi i një tutori/12 studentë për praktikën mësimore, dhe në përgjithësi 1 pedagog – tutor për zgjidhjen e gjithë problemeve që ka grupi i studentëve në ngarkim.</p>
<p><b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni organizon kurse trajnimi për pedagogët e rinj, si dhe programe specifike kualifikimi që financiarisht mbulohen prej tij. Për studimet e ofruara Institucioni disponon një bazë të dhënash të sakta të cilat i gjejmë tek plani mesimor dhe tek sylabuset e lëndëve që përfshihen në këtë plan.</p>
<p><b>Konkluzione të GVJ:</b></p> <p>Struktura akademike e Fakultetit dhe në veçanti e Departamentit të Ndërtimit del e qartë. Ka të dhëna të detajuara për raportet PAE/PAK (14/6), PA/P Administrativ (20/5), për cilësinë e stafit akademik (kualifikimin e tij) si 3 Prof.As, 7 Doktorë, 9 pa tituj, dhe 4 personel administrativ; për raportin meshkuj/femra(nga 1/1 deri 5/1); për moshën e personelit ku mbizotëron moshën nën 45 vjec.</p> <p>Gjithashtu nga pikëpamja e dokumentacionit, procedurave të rekrutimit dhe të dhënave për kualifikimin e stafit akademik çdo gjë është në rregull.</p>	

#### 4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

##### Pjesa përshkrimore

Nga pikëpamja e infrastrukturës, logjistikës dhe shërbimeve të tjera, Universiteti Epoka, është mjaft mirë i kompletuar. Kështu ai disponon mjedise mësimore (për leksione e seminare), laboratore, mencë, bibliotekë, salla interneti, terrene sportive, mjedise për aktivitete social-kulturore, si dhe nyje hidrosanitare të mjaftueshme për personelin dhe studentët. Gjithashtu mjediset administrative janë të mjaftueshme dhe të pajisura mirë.

##### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- |                                   |                                    |
|-----------------------------------|------------------------------------|
| • Salla për leksione              | 4 me sipërfaqe 511m <sup>2</sup>   |
| • Klasa për seminare              | 16 me sipërfaqe 1443m <sup>2</sup> |
| • Salla për aktivitete promovuese | 1 me sipërfaqe 128 m <sup>2</sup>  |



- Salla për praktikë lëndore/ profesionale 2 me siperfaqe 258 m<sup>2</sup>
- Laboratorë për lëndët 2 me siperfaqe 163 m<sup>2</sup>
- Laboratorë informatike 2 me siperfaqe 175 m<sup>2</sup>
- Laboratorri i ndërtimit 1 me siperfaqe 586 m<sup>2</sup>
- Salla interneti 2 me siperfaqe 158 m<sup>2</sup>
- Salla për bibliotekë 1 me siperfaqe 332 m<sup>2</sup>
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 1 me siperfaqe 85 m<sup>2</sup>
- Zyrë informacioni për studentët 1 me siperfaqe 56 m<sup>2</sup>
- Nyje hidrosanitare 32 me siperfaqe 310 m<sup>2</sup>

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 4 me siperfaqe 170 m<sup>2</sup>
- Zyra për sekretarinë mësimore 1 me siperfaqe 90 m<sup>2</sup>
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 10 me siperfaqe 225 m<sup>2</sup>
- Zyra për personelin akademik 40 me siperfaqe 620 m<sup>2</sup>

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka e pajisur me literaturën bazë dhe ndihmëse ofron 8000 libra për realizimin e programit të studimeve. Literatura në bibliotekë është e mjaftueshme që studenti të realizojë programin. Nga ana tjetër ekziston dhe libraria dixhitale ku studentët kanë akses online.</p> <p>Biblioteka disponon botime periodike, programe kompjuterike, revista shkencore, të cilat ndihmojnë studentin jo vetëm për asimilimin e lëndëve por dhe për kërkime shkencore.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit së bashku me titullarët e lëndëve hartojnë çdo vit një listë për literaturë të re, bazuar dhe në buxhetin që disponojnë. Biblioteka është në dispozicion të studentëve gjithë ditën duke ju shërbyer atyre më së miri.</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>Institucioni ofron 16 klasa me 1443 m<sup>2</sup> për 762 studentë; 4 salla leksionesh me 571 m<sup>2</sup> për 486 studentë; laborator të ndërtimit me 586 m<sup>2</sup> për 40 studentë; laborator kompjuterik me 271 m<sup>2</sup>, të gjitha</p>

**Kriteri 2** Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

**Kriteri 5** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.

**Kriteri 6** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

me sistem ngrohje-ftohje dhe të pajisura me teknologjinë më të fundit për mësimdhënie.

Pajisjet për mësimdhënie (tabela interaktive, projektorë, kompjuter, internet etj) plus ndriçimi e kondicionimi janë mjaft të mira.

Laboratorët, në përgjithësi, kanë pajisjet e nevojshme, ato kompjuterikë me 16 programe, të cilët përditësohen. Laboratori i ndërtimit ka nevojë të pajisjet për kryerjen e laboratorëve të Mekanikës së Dherave dhe të Shkëmbit me strukturë të prishur.

Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka një laborator të tij, të cilit duhet ti ndërrohet emri, pasi ai nuk është në gjëndje (për mungesë pajisjesh) të realizojë prova dinamike. Institucioni disponon laboratorë kompjuterik (82 kompjutera), të pajisur me programe profesionalë në fushat e statistikës, linguistikës, arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit, ekonomikut, shkencave sociale etj.

Për zhvillimin e praktikave profesionale, institucioni shfrytëzon mjediset e veta (për prova në hidraulikë dhe matje topografike), por pjesën më të madhe e realizon në objekte ndërtimore në formën e praktikës 1-2 ditore që i drejtojnë pedagogët e lëndëve.

Nga ana tjetër, në bashkëpunim me shumë firma (mbi 40 të tilla), me të cilat Institucioni lidh kontrata, realizohen praktikat verore nga 1-3 muaj, të cilat ndiqen nga një tutor i firmës dhe tutori i Institucionit.

### **Konkluzione të GVJ:**

Studentët kanë në dispozicion mjedis të mjaftueshme, të përshtatshme, të pajisura me teknologjinë e informacionit, për të zhvilluar në kushte shumë të mira procesin mësimor. Gjithashtu ata kanë në dispozicion tekste mësimore, literaturë ndihmëse sasijore e cilësore për realizimin e programit të studimeve, si dhe librarinë elektronike online. Institucioni ofron mjedis dhe laboratore për kryerjen e praktikës profesionale dhe mundësi për kryerjen e kësaj të fundit në firma të ndryshme.

### **REKOMANDIME**

1. Mendoj se laboratori i ndërtimit duhet të pajisjet me disa aparatura të thjeshta që shërbejnë për klasifikimin e dherave pasi në lëndën Mekanika e Dherave nuk kryhet asnjë provë.
2. Gjithashtu mendoj se për praktikën verore duhet të përpilohet një program nga ana e Departamentit, ku më pas studenti do të mund të realizojë ato pika që i ofron firma ku ai zhvillon praktikën.
3. Mendoj se është e domosdoshme t'u mësohet studentëve terminologjia teknike shqip (nëpërmjet një fjalori teknik) që të mos kenë vështirësi gjatë punës.



## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkimore

Të ardhurat e financimit nga 2011 – 2016 janë kryesisht nga studentët (që kanë ardhur në rritje) dhe nga grantet (3 vitet e para), si dhe nga aktivitetet tregëtare. Nga konsulenca, shërbime, sponsorizime, kualifikim i vazhdueshëm, donacione nuk ka patur financime.

Shpenzimet për 2011 – 2016 kanë qenë për paga, shpenzime për studentët dhe 2 vitet e para për kërkime me kontrata. Të ardhurat mesatare për student për 2011 – 2016 janë 1846 euro dhe shpenzimet për student 1342 euro.

Për problemin e financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare ka transparencë të plotë që realizohet nga kontrolli i ushtruar nga Turgut Ozal Education, dhe zyra e financës.

Të gjitha janë të pasqyruar saktë në gjithë dokumentacionin respektiv.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):
  - Grantet për kërkim ka patur vetem gjatë vitit 2012-2013
  - Konsulencat, shërbimet nuk ka të ardhura
  - Tarifat për dhe gjatë shkollimit është 1846 Euro
  - Sponsorizime nuk ka patur
  - Shërbimet trainuese (kual i vazhdueshëm) nuk ka të ardhura
  - Donacionet, aktivitetet sigurorese, fondacione etj nuk ka donacione
  - Aktivitetet tregëtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) ka të ardhura ku shuma është rreth 92.000.000/93.000.000 / ne vit
  
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kostot dhe shpenzimet per studentet janë 1342 euro

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga vizita ne institucion u verifikua ky dokumentacion në zyrën e financës dhe konstatohet se nuk ka ndryshime nga të dhënat e deklaruara.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p>	<p>Ka auditim të përvitshëm të situatës financiare nga Turgut Ozal Education sh.a. dhe nga zyra e financës e Institucionit. Raporti i auditimit përmban pagat, shpenzimet operative, grantet, taksat studentore dhe gjithë shërbimet nga kompani të treta. Grante të huaja për kërkim dhe kontrata ka patur vetëm më 2011- 2013 dhe nga auditi ato janë pasqyruar qartë.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	

## VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR

### Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

**Kriteri 1** Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

**Kriteri 2** Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

**Kriteri 3** Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Institucioni harton një raport financiar ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar: të ardhurat nga tarifat e shkollimit, kontribute të tjera dhe ndarjen e burimeve financiare.

Institucioni dokumenton raportet financiare për tre vitet e kaluara akademike. Institucioni ka qëndrueshmëri financiare, ka kapacitete të mjaftueshme për përmirësimin e gjendjes financiare, gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

#### **Konkluzione të GVJ:**

Institucioni ka bilanc pozitiv vjetor që garanton vijueshmërinë e tij.

#### **Rekomandime.**

Mendoj se mund të sigurojë të ardhura nga :

- 1- Përfitimi i projekteve nga programet e ndryshme Europiane
- 2- Projektet që realizohen për pushtetin vendor dhe qendror
- 3- Puna për të tretët (në laborator).

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### **Pjesa përshkimore**

Menaxhimi i cilësisë bëhet nga NJSBC sipas udhëzimit përkatës, i cili rregullon:

- a) procesin e vlerësimit të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe çdo shërbimi në Universitetin Epoka;
- b) zhvillimin e cilësisë, ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- c) miratimin e treguesve të cilësisë etj.

Këshilli i vlerësimit akademik të zhvillimit të cilësisë (KVAZHC) si njësi qendrore e SBSC është përgjegjës për një sërë pikash ku pika (a) është shumë e përgjithshme, pika (b) nuk

përcakton qartë se cilët janë objektivat strategjik afat shkurtër, afat mesëm dhe afat gjatë, pika (c) nuk jepet një shembull për një projekt apo program strategjik.

Universiteti Epoka është pajisur në vitin 2010 me çertifikatë ISO 9001: 2008 për sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila ripërtërihet çdo 3 vjet.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Puna konkrete e NJSBC është : hartimi i pyetsorëve për çdo pedagog (me 14 përbërës që u përgjigjen studentët), renditja e pedagogëve sipas vlerësimit, rekomandimet për rregullimin e mësimdhënies, analiza simestrale e rezultateve të studentëve, kontrolle dhe vizita në leksione nga dekani dhe shefi i departamentit, raporti i vetëvlerësimit dhe vlerësimeve të jashtme, raporti i auditit të brendshëm, organizim seminaresh, trajnimesh për rritjen e cilësisë.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë është realizuar me kontroll të brendëshëm (nëpërmjet sylabusave të lëndëve) dhe i jashtëm (anketimet e studentëve, kontrollet nga shefat e departamenteve etj).

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Universiteti harton njëherë në vit një raport vetvlersimi i cili i paraqitet Keshillit të Lartë të Universitetit. Rezultatet kanë qënë pozitive.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Grupi përgjegjës për sistemet e menaxhimit të cilësisë mbi bazën e vetvlersimeve periodikeve harton politika për përmisimin e procesit të mësimdhënies.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga vizita e kryer në institucion konstatojmë se dokumentacioni lidhur me problematiken e mësipërme është i rregullt dhe është në përputhje me standartet.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p align="center"><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b></p> <p><b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme,</p>	<p>Metodologjia dhe instrumentat për matjen e ecurisë së programit të studimit kryhet nga KVAZHC nëpërmjet komisioneve të vlerësimit</p>



<p>rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>periodik. Informacioni i kërkuar përfshihet në raportin e vetëvlerësimit.</p> <p>Publikohen rezultatet e pritshme nga vlerësimet e studentëve dhe stafit akademik, si dhe ato të pritshmet nga diskutimet mbi përmbajtjen e ndryshimet në lëndët e ndryshme.</p> <p>Ndërkaq përdoren dhe metoda të tërthorta nëpërmjet anketimeve të studentëve, sondazheve, intervistave për përmisimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>
---	---

### VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

#### **Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni i ka plotësuar standartet dhe është akredituar në nivel institucional.</p> <p>Institucioni përdor instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë, si ato të drejtpërdrejta (rishikimi i sylabusave) dhe ato të tërthorta (vlerësime të studentëve për brendinë e lëndës, praktikat, diplomat, mënyrat e vlerësimit të punës së tyre etj).</p> <p>Institucioni harton politika për procedurën e vlerësimit periodik (ndonëse nuk dalin shumë të qarta ato), dhe në fund të vitit rezultatet e vlerësimit i dorëzohen tek pedagogët.</p> <p>Mekanizmat formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit realizohen nëpërmjet: senatit (që harton politikat e zhvillimit të institucionit), vlerësimit (pas programimit) të veprimtarisë mësimore-shkencore për efikasitetin e tyre, dhe vendimeve për vazhdimin e punës në të ardhme, duke përdorur hierarkinë vertikale</p>
---	---

	<p>departament- fakultet – rektorat.</p> <p>Ndërgjegjësimi i personelit dhe studentëve realizohet nëpërmjet guidave të stafit e studentëve, trajnimeve periodike dhe këshillimeve të studentëve.</p> <p>Strategjia për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë është: kualifikimi i vazhdueshëm i pedagogëve, bashkëpunimi mes pedagogëve e studentëve për arritjen e rezultateve sa më të mira, kërkesa të qarta për vlerësimin e studentëve, rritja cilësore e shërbimeve të tilla si biblioteka, literatura, teknologjitë informative.</p>
<p><b><u>Konkluzione të GVJ:</u></b></p> <p>Bazuar në planin strategjik, institucioni harton një analizë vjetore të ecurisë së programit të studimeve të ciklit të parë; harton politika për përmirësimin e programit të studimeve, dhe përdor instrumentat e duhur për sigurimin e cilësisë. Institucioni synon dhe përdor metodat e duhura për ndërgjegjësimin e personelit dhe të studentëve për rritjen e vazhdueshme të cilësisë. Gjithë rezultatet e kësaj veprimtaria gjithë përfshirëse (student-pedagog) përfshihen në raportin e vetëvlerësimit, dhe ato publikohen.</p>	

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

*Misioni i Departamentit të Ndërtimit është i qartë. Qëllimet dhe objektivat lëndore janë dhënë mjaft të plotë në syllabuset programit të Inxhinierisë së Ndërtimit*

#### **Pjesa përshkrimore**

Plani mësimor është i qartë dhe i plotë për tre vitet e studimit të ciklit të parë, ku përfshihen 10 lëndë në vitin e I, 11 lëndë në vitin e II dhe 11 lëndë në vitin e III (përfshirë dhe mikrotezën). Për çdo lëndë në planin mësimor janë evidentuar kreditet, orët në javë, orë leksioni, seminare, laboratore dhe praktike (të ndara në orë në klasë dhe punë e pavarur e studentëve).

Nga diskutimet mendohet që mikroteza të realizohet vetëm për studentët me rezultate shumë të mira, kurse të tjerët ta mbyllin ciklin e parë me provim formimi. Gjithashtu mendojmë se ka një ndarje të drejtë mes lëndëve të formimit të përgjithshëm (31 ECTS) atyre të formimit profesional (102 ECTS), atyre integruese (15 ECTS), lëndëve me zgjedhje (5 ECTS), për përsosjen e gjuhës angleze (11 ECTS na duken shumë), për praktikën verore (5 ECTS) dhe mikrotezën ose provimin e formimit (6 ECTS).

Misioni dhe objektivi i programit të studimit për Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi jepet në planin mësimor dhe në programet e lëndëve. Kështu, nga Institucioni, që në fillim të vitit shkollor shpallen objektivat e programit të studimit me 3 vite (cikli i I), ku një vit akademik ka 32 javë mësimore (përfshirë dhe javët e provimeve). 1 vit akademik vlerësohet me 60



ECTS; 1 ECTS = 25 orë mësimore për studentin; 1 orë mësimore është 60 minuta dhe emërtimi i diplomës është Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi.

Për çdo lëndë në planin mësimor janë evidentuar kreditet, orët në javë, orë leksioni, seminare, laboratore dhe praktike (të ndara në orë në klasë dhe punë e pavarur e studentëve).

Ka një profilizim të pedagogëve sipas disiplinave, dhe për dhënien e leksioneve e seminareve etj janë pedagogë me formim mjaft të mirë me titullin Prof.As, gradën Dr, ose në punë e sipër për marrjen e kësaj grade dhe me M.Sc.

Pedagogët në përgjithësi japin një lëndë, ose 2-3 lëndë që janë të të njëjtit trung dhe vazhdim i njëra-tjetrës.

Në sylabuset e çdo lëndë pasqyrohen gjithë elementët e nevojshëm: emërtimi ose moduli; viti dhe semestri; emri i pedagogut; vëndi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; njohuritë paraprake të studentit për përvehtësimin e lëndës; njohuritë që i jep studentit lënda; temat që do të trajtojë lënda (teorike e praktike); ngarkesën orë/javë (në auditor dhe jasht tij); forma e metoda e mësimdhënies; format e vlerësimit të studentit; detyrimet e studentit për lëndën; literatura e detyruar dhe ndihmëse.

Nga analiza e cilësisë së sylabuseve na rezulton se ato nga ana formale janë në rregull me kërkesat e hartimit të tyre, dhe nga përmbajtja i përgjigjen kërkesave të kohës për çdo lëndë respektive duke i dhënë studentëve njohuritë e nevojshme e të domosdoshme që e përgatitin atë për qëllimin dhe objektivin që duhet të arrijnë me mbylljen e ciklit të parë.

Ndryshimet në planin mësimor janë brenda kufijve të pranuar, ato nuk ndikojnë në përmbushjen e standarteve, dhe janë pasqyruar plotësisht në sylabuset e lëndëve.

Plani mesimor I plotë është bashkëngjitur në Anekset e këtij Raporti (shih anekset)

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore (përfshirë dhe javët e provimeve)
- 1 ECTS = 25 orë mësimore për studentin
- 1 orë mësimore është 60 minuta
- 1 vit akademik ka 60 ECTS

Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Viti i parë ka 10 lëndë dhe përfundon me 9 provime. Viti i dyte ka 11 lëndë dhe përfundon me 11 provime. Viti i tretë ka 10 lëndë dhe përfundon me 9 provime, dhe së fundmi është mikroteza e përfunimit të studimeve të ciklit të parë.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet            1552 orë në auditor dhe 1828 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret        448 orë në auditor dhe 447 orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratoret       22 orë në auditor dhe 3 orë punë e pavarur

- *Për Praktikën lëndore* 82 orë në auditor dhe
- *Për Praktikën Profesionale* 171 ore punë e studentin në firmat e ndërtimit
- *Provimi përfundimtar* 2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Janë ndryshuar ECTS për këto programe mësimore:

- *Lëndë më zgjedhje jo teknike nga 4 ECTS u ndryshua në 5 ECTS,*
- *CE 392 REINFORCED CONCRETE FUNDAMENTALS nga 5 ECTS u ndryshua në 6 ECTS,*
- *CE 394 STRUCTURAL ANALYSIS nga 5 ECTS u ndryshua në 6 ECTS.*
- *Po ashtu është ndryshuar semestri për lëndën CE 281 – SURVEING nga semestri i III në semestrin e IV.*

Këto ndryshime nuk kanë prekur cilësisinë e programit të studimeve.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Ka një profilizim të pedagogëve sipas disiplinave, dhe për dhënien e leksioneve e seminareve etj janë pedagogë me formim mjaft të mirë me titullin Prof.As., gradën Dr. ose në punë e sipër për marrjen e kësaj grade dhe me M.Sc.

Pedagogër në përgjithësi japin një lëndë, ose 2-3 lëndë që janë të të njëjtit trung dhe vazhdim i njëra-tjetrës.

Shih Tabelën 16 të personelit akademik lidhur me planin mesimor (ne Aneks)

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Në sylabuset e çdo lënde pasqyrohen gjithë elementët e nevojshëm : emërtimi ose moduli; viti dhe simestri; emri i pedagogut; vëndi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; njohuritë paraprake të studentit për përvehtësimin e lëndës; njohuritë që i jep studentit lënda; temat që do të trajtojë lënda (teorike e praktike); ngarkesën orë/javë (në auditor dhe jasht tij); forma e metoda e mësimdhënies; format e vlerësimit të studentit; detyrimet e studentit për lëndën; literatura e detyruar dhe ndihmëse

Analizë e cilësisë së sylabuseve

Nga analiza e cilësisë së sylabuseve na rezulton se ato nga ana formale janë në rregull me kërkesat e hartimit të tyre, dhe nga përmbajtja i përgjigjen kërkesave të kohës për çdo lëndë respektive duke i dhënë studentëve njohuritë e nevojshme e të domosdoshme që e përgatitin atë për qëllimin dhe objektivin që duhet të arrijnë me mbylljen e ciklit të parë. Ndryshimet në planin mësimor janë brenda kufinjve të pranuar, ato nuk ndikojnë në përmbushjen e standarteve, dhe janë pasqyruar plotësisht në sylabuset e lëndëve.

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

Nga vizita në institucion u verifikua të gjitha sylabuset e lëndëve për programin e BSc Inxhinieri Ndërtimi, dhe konstatojmë se nuk ka ndryshime dhe janë në përputhje me standartet.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programet janë të akredituara dhe të vlerësuara me kredite. Është respektuar sasia e krediteve 60ECTS/vit.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për sylabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Në faqen e internetit jepen gjithë informacionet për njohuritë e përgjithshme të ciklit të parë (lëndë me detyrim e me zgjedhje). Jepet informacioni i plotë për sylabuset e gjithë lëndëve.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit jep gjithë informacionin e nevojshëm për ngarkesën në auditor e jasht tij, frekuentimin, detyrimet etj.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit jep informacion për çdo sylabus. Studentët ndihmohen shumë nga këshilltarët e tyre (tutori) për tu akomoduar me kërkesat për përvehtësimin e lëndëve.</p>
<b><u>Konkluzionet e GVJ:</u></b>	
<p>Programi i studimit i ciklit të parë është organizuar me module dhe vlerësohet me ECTS 60 x 3 = 180.</p> <p>Programi është shumë transparent dhe i detajuar, i shpallur në internet duke shprehur qartë ngarkesën në auditor dhe jasht tij, praktikatat, labororet, format e vlerësimit të përvehtësimit të lëndës nga studentët etj.</p> <p>Mësimdhënia është organizuar mjaft mirë, ku janë kombinuar drejt orët në klasë me ato në laborator dhe orët jasht klase (praktikat mësimore dhe ato profesionale) me punën e pavarur të studentëve. Edhe kontrolli i dijeve është në përputhje me rregulloren e studimeve.</p> <p>Mendoj se gjatë këtij procesi, një sukses për rritjen e cilësisë është bashkëveprimi e bashkëpunimi pedagog-student.</p>	

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

Mësimdhënia në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit realizohet sipas rregulloreve të studimeve dhe të provimeve. Leksionet dhe seminarët zhvillohen në auditore duke përdorur teknika moderne të mësimdhënies. Studentët kanë mundësi të realizojnë një pjesë të mirë të laboratorëve për lëndët Material Ndërtimi, Hidraulikë, betoneve në veçanti dhe agregateve etj, në laboratorin e ndërtimit. Në këtë laborator mund të ekperimentohen dhe struktura murature në ngarkim horizontal në shkallë relativisht të madhe dhe trarë B-A. Studentët asimilojnë lëndët jo vetëm nëpërmjet studimit të literaturës (që është e bollshme), por edhe nëpërmjet detyrave e projekteve të kursit, si dhe praktikave mësimore që bëhen në Institucion (Topografi, Gjeologji etj) dhe praktikave profesionale (në firma të ndryshme ndërtimore).

Format e kontrollit të dijeve bëhen sipas rregulloreve të studimeve me provime në mes të simestrit dhe në fund të tij. Provimet realizohen me shkrim, por ka dhe me gojë para një komisioni. Studentët kanë të drejtë të kontestojnë provimin brenda javës duke paraqitur ankesë në sekretari. Ankesa shqyrtohet në departament dhe vendimin e merr Këshilli Administrativ i Fakultetit.

Vlerësimi i studentëve bëhet në bazë të sistemit Amerikan dhe sistemit Europian, ku jepen shpjegime shumë të qarta qoftë për konvertimin e njërit sistem me tjetrin, ashtu dhe për notat me shkronja.

Vlerësimi i brendshëm bëhet nga KVAOC, i cili krijon, zhvillon dhe vlerëson SBSC. Ai gjithashtu vlerëson e miraton nivelin e cilësisë nga vlerësuesit e jashtëm. Aktivizimi i studentëve në vlerësimin e brendshëm nëpërmjet pyetësorëve, anketimeve etj është shumë i rëndësishëm si proces. Gjithashtu, në raste të veçanta, ngrihen dhe ekipe për vlerësimin e mësimdhënies në gjithë komponentët e saj.

Vlerësimi i jashtëm i këtij procesi bëhet nga institucione të certifikuara si në vitin 2010 sipas ISO 9001:2008, verifikim nga GAB dhe në fund të çdo viti me anë të një raporti vetëvlerësimi nga Këshilli i Auditimit.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksionet zhvillohen me projektor në tabela interaktive, me metoda tradicionale.
- Seminarët dhe ushtrimet zhvillohen në klasë dhe jashtë saj me punë të pavarur të studentëve.
- Labororet zhvillohen me grupe të vogla në lëndët materiale ndërtimi dhe strukturore.
- Lëndët në përgjithësi kanë detyra kursi e projekte të cilat shërbejnë për asimilimin e lëndës dhe formimin e shprehive praktike.
- Praktikë lëndore zhvillohet në hidraulikë, topografi dhe gjeologji inxhinierike.
- Praktikë profesionale zhvillohet pranë

Format e kontrollit të njohurive



Format e kontrollit të dijeve bëhen sipas rregullores së studimeve me provime në mes të simestrit dhe në fund të tij. Provimet realizohen me shkrim, por ka dhe me gojë para një komisioni. Studentët kanë të drejtë të kontestojnë provimin brenda javës duke paraqitur ankesë në sekretari. Ankesa shqyrtohet në departament dhe vendimin e merr Këshilli Administrativ i Fakultetit.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Vlerësimi i studentëve bëhet në bazë të sistemit Amerikan dhe sistemit European, ku jepen shpjegime shumë të qarta qoftë për konvertimin e njërit sistem me tjetrin, ashtu dhe për notat me shkronja.

Vlerësimi i brendshëm bëhet nga KVAOC, i cili krijon, zhvillon dhe vlerëson SBSC. Ai gjithashtu vlerëson e miraton nivelin e cilësisë nga vlerësuesit e jashtëm. Aktivizimi i studentëve në vlerësimin e brendshëm nëpërmjet pyetësorëve, anketimeve etj është shumë i rëndësishëm si proces. Gjithashtu, në raste të veçanta, ngrihen dhe ekipe për vlerësimin e mësimdhënies në gjithë komponentët e saj.

Vlerësimi i jashtëm i këtij procesi bëhet nga institucione të certifikuara si në vitin 2010 sipas ISO 9001:2008, verifikim nga GAB dhe në fund të çdo viti me anë të një raporti vetëvlerësimi nga Këshilli i Auditimit.

#### **Konkluzionet e GVJ:**

Mësimdhënia është organizuar mjaft mirë, ku janë kombinuar drejt orët në klasë me ato në laborator dhe orët jashtë klase (praktikat mësimore dhe ato profesionale) me punën e pavarur të studentëve. Edhe kontrolli i dijeve është në përputhje me rregulloren e studimeve. Mendoj se gjatë këtij procesi, një sukses për rritjen e cilësisë është bashkëveprimi e bashkëpunimi pedagog-student.

## **9. Studentët**

#### **Pjesa përshkrimore**

Për t'i paraprirë pranimin të studentëve, Universiteti Epoka informon nxënësit e shkollave të mesme nëpërmjet Zyrës së Programit të Planifikimit të Karrierës për të gjitha detajet e programeve të studimit, si dhe nëpërmjet vizitave të organizuara në shkollat e mesme. Kushtet e pranimin janë shumë të qarta. Numuri i pranimeve është sipas kushteve të Fakultetit. Lejohen transferime nga brenda dhe jashtë institucionit.

#### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

- Procedurat e pranimin të studentëve

Në procedurat e pranimin përfshihen vec të tjerave mesatarja e notës mbi 7 në gjuhën angleze dhe mbi 6 matura shtetërore; pikët e provimit të maturës shtetërore dhe certifikata e gjuhës angleze.



Në programin master (2 të tillë në ndërtim) mesatarja duhet të jetë mbi 7,5 dhe certifikata e gjuhës angleze niveli B-2. Në masterin profesional (1 i tillë në ndërtim) mesatarja duhet të jetë mbi 6 dhe anglishtja në nivelin B-1. Për PhD (1 në ndërtim) mesatarja duhet të jetë mbi 8 dhe anglishtja në nivelin C.

Numri i studenteve ne programin e studimit:

Viti akademik	Numri i studenteve te regjistruar	Mobiliteti i studentëve brenda sistemit	Nota mesatare	Viti i diplomimit	Numri i studenteve te diplomuar	Nota mesatare ne diplomim
2012-1013	25	3	8.74	2015	16	3.01/4.0
2013-1014	19	2	8.56	2016	9	2.54/4.0
2014-1015	22	2	9.21	2017		
2015-1016	21	1	9.17	2018		
2016-1017	19	3	9.01	2019		
	<b>106</b>	<b>11</b>	<b>8.93</b>		<b>25</b>	

Aktualisht ne tre vitet deklarohen 70 studentë në të tre vitet

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve.

Cilësia në hyrje e studentëve është në përputhje të plotë me ligjin e arsimit të lartë dhe rregullat e institucionit. Në dalje studentët në përgjithësi kanë mesatare deri në të mirë.

- Nga vizita në institucion rezulton se cilësia e pranimeve ka ardhur në rritje. Gjithashtu kalueshmëria është rreth 65% me notë mesatare 2.24/4, pra ka kërkesë llogarie dhe për rritjen e cilësisë.
- Numuri i studentëve të ardhur nga universitete të tjera varion nga 1 – 5.
- Një rezultat shumë pozitiv që konfirmon se programi i studimeve është cilësor dhe i përgjigjet kërkesave të kohës, është se gati 90% e studentëve që mbarojnë ciklin e parë punësohen (në 37 kompani janë punësuar 131 studentë).
- Vetëm në periudhën 2011 – 2016 numuri i të diplomuarve është 109 nga të cilët 78 janë punësuar sipas profilit, 3 jasht profilit, 2 të papunë, 6 për PhD dhe 20 për MSc.
- Një rëndësi të vecantë ka panairi i pranverës, ku këtë vit morrën pjesë rreth 50 kompani, të cilat shfaqin vazhdimisht interes për të punësuar studentë nga Universiteti Epoka. Në 37 kompani studentët kryejnë praktikën verore.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e</p>	<p>Pranimi i studentëve bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Kritere të veçanta janë mesatarja, pikët e provimit të maturës shtetërore, gjuha angleze.</p>

parë të studimeve.	
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët informohen çdo fillim viti për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Çdo fund simestri, me anën e anketimeve dhe të pyetsorëve bëhet vlerësimi i pedagogëve nga studentët.</p> <p>Shërbimi i këshillimit për studentët i orienton ata drejt tregut të punës. Kësaj i shërbejnë panairët e ndryshme, seminarët, praktikat në kompani të ndryshme dhe trajnimet.</p> <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës, lidhjet e forta me biznesin, panairët e punësimit, informimi dy palësh, janë mundësi reale informimi për punësimin e të diplomuarve,</p>
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve dhe mban lidhje të vazhdueshme me ta.</p> <p>Institucioni ka statistika të sakta për studentët e regjistruar në ciklin e parë, sa e kanë përfunduar, sa janë larguar apo nuk e kanë përfunduar.</p> <p>Sekretaria mësimore disponon dokumentacion shumë të rregullt për ecurinë e studentëve.</p>
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Gjatë gjithë kohës, nëpërmjet ZPK realizohet "Këshillim i karrierës" që është në ndihmë të studentëve gjatë procesit mësimor.</p> <p>Sistemi i mentorit për grupin e studentëve është shumë efikas.</p> <p>ZKK ndihmon studentët për kryerjen e praktikës në kompani të ndryshme.</p>
<b>Konkluzionet e GVJ</b>	
<p>Pranimi i studentëve në cklën e parë në Universitetin Epoka, bëhet në përputhje me ligjin 80/2015 dt. 22.7 2015 për Arsimin e lartë, si dhe mbi bazën e kriterëve shtesë. Studentët marrin informacion të plotë, në fillim të vitit nëpërmjet guidës së studentit dhe faqes zyrtare, për programin e studimit, mënyrën e organizimit dhe kohëzgjatjen e tij.</p> <p>Puna e stafit akademik dhe procesi mësimor vlerësohet në rradhë të parë nga studentët nëpërmjet anketimeve e pyetsorëve. Këto vlerësime u bëhen të njohura pedagogëve dhe shefave të departamenteve dhe janë baza për rinovimin e kontratave të punës me pedagogët, si dhe për vendosjen e pedagogëve në secilën lëndë.</p> <p>Shërbimi i këshillimit që u ofrohet studentëve dhe sistemi i mentorit i ndihmon studentët jo</p>	

vetëm gjatë procesit mësimor për kapërximin e vështirësive, por dhe i orienton ata drejt tregut të punës gjatë praktikave verore.

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

Në Departamentin e Ndërtimit kërkimi shkencor shprehet nëpërmjet publikimeve shkencore të vlerësuara mirë, pjesëmarrjeve në konferenca shkencore, organizimin dhe bashkë organizimin e konferencave shkencore në Universitetin Epoka, të ndihmuara dhe nga mbështetja financiare e institucionit (për një pjesëmarrje në vit paguan institucioni). Gjatë 2015 – 2016 ka patur 24 botime në revista shkencore dhe proceedings.

Qendra e kërkimit dhe e projektimit në arkitekturë CARDA ka një fushë të gjerë aktiviteteve si: kontributi në kërkimin akademik mbi mjedisin dhe ndërtesën, projekte arkitektonike, urbanistike e pejsazhi, ndërtimi i urës lidhëse industri – akademi, shërbime konsulence etj. Aktiviteti i qendrës përfshin: NJPUE (njësinë e projektimit) që kryen projekte profesionale, bashkëpunon me studjues të ndryshëm, ka projektuar kampusit universitar, publikon rezultatet e projekteve. Organet administrative të qendrës janë: drejtori (nga stafi akademik) që zgjidhet i herë në katër vjet, bordi administrativ (5 veta), grupi i projektimit (sipas nevojës). Stafi teknik i qendrës përbëhet nga asistentë dhe të diplomuar (mbi bazë projekti), dhe stafi praktikant përbëhet nga të diplomuarit dhe studentë.

Menaxhimi financiar i qendrës kryhet nga rektori. Llojet e aktiviteteve mund të përmbliken në: 7 projekte të ndryshme, 2 konferenca shkencore të organizuara nga Universiteti Epoka, IBCC-2011 me tre universitete të tjera me 130 pjesëmarrës dhe IBCC-2013 me dy universitete të tjera me 150 pjesëmarrës.

Në lidhje me marrëdhëniet me tregun e punës dhe me biznesin 80% e studentëve e kanë kryer praktikën në Shqipëri, Turqi, Kosovë, Greqi.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- |                                     |  |       |
|-------------------------------------|--|-------|
| <input checked="" type="checkbox"/> | Të dhëna për kërkimin shkencor: Institucioni disponon të dhëna të plota për kërkimin shkencor, fushat e kërkimit, pjesëmarrje në evente, botime e publikime etj. |       |
| <input checked="" type="checkbox"/> | Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL është  | 127   |
| <input checked="" type="checkbox"/> | Numri i projekteve kërkimore të fituara është  | 15    |
| <input checked="" type="checkbox"/> | Numri i projekteve të zbatuara është   | 8     |
| <input checked="" type="checkbox"/> | Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL është  | 10    |
| <input checked="" type="checkbox"/> | Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL është   | 94    |
| <input checked="" type="checkbox"/> | Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor është  | 45    |
| <input checked="" type="checkbox"/> | Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor është   | 45    |
| <input checked="" type="checkbox"/> | Numri i Çmimeve Kombëtare -  | asnjë |



Vërejmë se nuk ka ndryshime me të dhënat e deklaruara dhe se me këtë aktivitet shkencor Institucioni i plotëson standartet që lidhen me këta trgues.

## **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

### **Pjesa përshkrimore**

Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit si pjesë përbërëse e FAN dhe Universitetit Epoka, ka një bashkëpunim të mirë kombëtar e ndërkombëtar me institucione të tjera të arsimit të lartë, me pushtetin lokal, me universitetet e huaja, me biznesin etj.

Ky bashkëpunim i shërben kërkimit shkencor, rritjes së nivelit të mësimdhënies dhe lidhjes së Institucionit me praktikën.

Një rol për kërkimin shkencor ka dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, e cila nëpërmjet zhvillimit, zbatimit të politikave ndërkombëtare promovon jasht Universitetin Epoka. Kjo zyrë negocion marrëveshje, informon pedagogët e studentët për mundësitë e ndryshme ndërkombëtare, si praktika verore, diploma të përbashkëta, bursa ndërkombëtare, aktivitete kulturore e shkencore jasht vendit, programe ndërkombëtare (evente, konferenca, vizita), organizon aktivitete për ekspozimin e kulturave të ndryshme me studentët etj.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare është 15
- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj për vitin 2015-2016 është 13
- Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit nuk kishte
- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL për vitin 2015-2016 ishte 6 studente nga IAL dhe 22 studente drejt IAL
- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor janë laboratorit i ndërtimit dhe 2 të informatikës.
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime është 188.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- |  |    |
|--|----|
| ▪ Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese janë | 38 |
| ▪ Organizatat Profesionale janë                    | 26 |
| ▪ Komuniteti i biznesit, tregu i punës janë        | 54 |

Dokumentacioni përkatës

Një rol për kërkimin shkencor ka dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, e cila nëpërmjet zhvillimit, zbatimit të politikave ndërkombëtare promovon jasht Universitetin Epoka. Kjo

zyrë negocion marrëveshje, informon pedagogët e studentët për mundësitë e ndryshme ndërkombëtare, si praktika verore, diploma të përbashkëta, bursa ndërkombëtare, aktivitete kulturore e shkencore jasht vendit, programe ndërkombëtare (evente, konferenca, vizita), organizon aktivitete për ekspozimin e kulturave të ndryshme me studentët etj.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Ka shkëmbim informacioni mes personelit Garantohen marrëdhënie të frutshme bashkëpunimi mes stafit akademik nëpërmjet ndarjes së detyrave, përgjegjësive dhe analizës së vazhdueshme të punës.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Ka një marrëdhënie shumë të mirë bashkëpunimi me homologët jasht (lëvizje stafi dhe studentësh, konferenca ndërkombëtare, projekte të përbashkëta) dhe me biznesin (projekte të përbashkëta) Marrëdhënie bashkëpunimi për praktikatat profesionale (gjatë verës), të cilat mbikëqyren nga kompanitë (54 të tilla) dhe vlerësojnë studentët.</p> <p>Ka disa trajnime profesionale nëpërmjet Qendrës së Edukimit të Vazhduar, të cilat vazhdojnë formimin e specialistëve dhe bëjnë të mundur mbajtjen e lidhjeve mes tyre dhe IAL. Ka 31 raporte mbi përfitimet nga marrëveshjet me universitete nga 9 shtete (për 65 studentë) dhe nga Turqia drejt Universitetit Epoka (18 studentë) Në Erasmus+ janë të angazhuar 35 studentë e pedagogë nga universitetet e huaja dhe 7 pedagogë nga Universiteti Epoka.</p>
<p><b>Konkluzionet e GVJ:</b></p> <p>Universiteti Epoka nxit dhe inkurajon bashkëpunimin shkencor mes stafit akademik për realizimin e kërkimit dhe projekteve në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Ai ndjek një strategji bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel kombëtar e ndërkombëtar për arritjen e misionit dhe qëllimit të tij. Favorizon lëvizjen e pedagogëve e studentëve, dhe pjesëmarrjen e tyre në konferenca kombëtare e ndërkombëtare. Ndjek një politikë favorizuese për pedagogët që kanë shumë botime në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca. Krijon mundësi të shumta për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve brenda dhe jasht vendit nëpërmjet marrëdhënieve të shumta të bashkëpunimit.</p>	



## **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Nga akreditimi i parë janë plotësuar rekomandimet:

- Për harmonizimin e kredive Amerikane me ato Europiane
- Për kompletimin e bibliotekës
- Për stimulimin e punës individuale të studentëve
- Për profilizimin më të qartë të stafit
- Për koordinimin më të mirë të periudhës të profesorëve vizitues.

### **II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES - MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT).**

#### **a. Pika të forta:**

Në pikat e forta mendoj se klasifikimi i kryer sipas GVB është i drejtë dhe shumë i detajuar. Kështu për menaxhimin kemi 4 pika të forta, për procesin mësimor 23 pika, për marrëdhëniet mes universitetit e industrisë apo shoqërisë 3 pika, për infrastrukturën e mjedisin 7 pika, për marrëdhëniet me BE e shtete të tjera 3 pika, për imazhin e UE dhe satisfaksionin e palëve të interesuara 8 pika.

Konkretisht mendoj se pika të forta janë:

- I. Menaxhimi** gjithëpërfshirës, i hapur përkundrejt risive
- II. Proces cilësor i mësimdhënies**, 100% në anglisht, me kurrikula cilësore dhe me Metoda ndërdisiplinore. Përdorimi i pajisjeve teknologjike moderne (projektorë, smart board) në procesin e mësimdhënies; Përdorimi i literaturës bashkëkohore të autorëve dhe i burimeve të tjera të botuara; Vlerësimi i saktë dhe i drejtë i performancës së studentëve
- III. Performancë e mirë e stafit akademik** dhe me përvojë ndërkombëtare, organizimi i vazhdueshëm i konferencave ndërkombëtare, seminarëve dhe ngjarjeve të ngjashme shkencore. Kjo evidentohet nga vlerësimi i rregullt i performancës së stafit akademik nga studentët. Marrëdhënie dhe komunikim cilësor ndërmjet stafit;
- IV. Disponimi i laboratorëve** që përdoren në procesin mësimor dhe kërkimor;
- V. Rritja e numrit të programeve kërkimore** financuar nga burime të brendshme dhe të jashtme;
- VI. Procesi i përzgjedhjes** për regjistrimin e studentëve që ka sjellë cilësi të mirë e pjesës më të madhe të studentëve të regjistruar;
- VII. Shumëllojshmëria e kombësive** të studentëve dhe ofrimi i bursave të pjesshme dhe të plota për të tërhequr studentët e suksesshëm;
- VIII. Infrastruktura**, ambienti i punës dhe kushtet e mira, si:

- Kampus universitar modern, kushtet e përshtatshme fizike në ambientin e punës, hapësira të gjelbra në kampus
- Abonimi i universitetit në baza të ndryshme të dhënash të bibliotekave elektronike, lehtësira të shumta mbi aksesin e informacionit dhe në burimet elektronike të informacionit

**IX. Marrëdhëniet** mes Universitetit dhe industrisë/shoqërisë, BE dhe shtete të tjera, që reflektohet në:

- Marrëdhënie cilësore me institucionet publike dhe sektorin privat; Marrëdhënie të institucionalizuara me universitetet e huaja
- Lidhje të ngushta dhe bashkëpunim me administratën lokale dhe organizatat joqeveritare
- Organizimi dhe implementimi i programeve trajnuese
- Lidhje në programet e shkëmbimit të studentëve midis universiteteve shqiptare dhe të huaja. Staf akademik me përvojë dhe nivel të lartë sukcesi në përfitimin nga projektet e ofruara të BE

**X. Imazhi i Universitetit Epoka** dhe satisfaksioni i palëve të interesuara, që duket në:

- Ekzistenca e imazhit pozitiv përballë institucioneve të jashtme dhe përballë publikut shqiptar
- Satisfaksion i lartë i studentëve nga Universiteti Epoka
- Ekzistenca e ciklit të mbyllur arsimor nga niveli parashkollor deri në ciklin e tretë të studimeve në institucionet arsimore që i përkasin kompanisë “Turgut Ozal”
- Mbështetja e stafit akademik dhe administrativ për përmbushjen e misionit të universitetit
- Bashkëpunim i konsoliduar me profesionistë në treg

**b. Pika të dobëta:**

**I. Në menaxhim,** për shkak të:

- Diversitetit kulturor të stafit të universitetit;
- Kryerjes së pjesës më të madhe të proceseve dhe operacioneve të punës në më shumë se një gjuhë dhe në pjesën më të madhe, në gjuhë joamtare
- Koncepti i universitetit privat është relativisht i ri në Shqipëri.

**II. Në nivelin e përdorimit të burimeve** dhe mjeteve, si:

- Burime të kufizuara financiare; Informacion i kufizuar për mundësitë e financimit të jashtëm

- Mbështetje e kufizuar financiare në lidhje me zhvillimin e kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore si dhe për zbatimin e projekteve kërkimore
- Akses i kufizuar mbi financimet e BE-së për shtetet jo anëtare dhe shtetet kandidate në BE;

### III. Në procesi i mësimit, si:

- Nivel i ulët i njohurisë së gjuhës angleze nga ana e një pjese të studentëve;
- Numri relativisht jo i lartë i studentëve

### IV. Marrëdhënia me shoqërinë dhe aksionerët, si:

- Mungesë e promocionit të mjaftueshëm të universitetit ndaj publikut të gjerë dhe grupeve të synuara;
- Mungesa e njohjes së gjuhës shqipe nga një pjesë e stafit të huaj, lidhur me ndjekjen e rregullt të zhvillimeve sociale, ekonomike dhe politike në vend;

Në pikat e dobta të dhëna më sipër mendoj se klasifikimi i kryer sipas GVB është i drejtë dhe shumë i detajuar. Por mendoj se duhen shtuar edhe:

- Sfida për të menaxhuar më mirë shërbimet në mencë përvoja të përkjet cilësisë;
- Menaxhim më i mirë i jetës social-kulturore të studentëve në kampusin univesitar.
- Më shumë pajisje për laboratorin e ndërtimit, që të mund të zhvillohen një minimum provash në lëndën 'Mekanika e Dherave'.
- Një minimum tekstesh teknike në gjuhën amëtare.
- Gjetja e mundësive për tu mësuar studentëve fjalorin teknik ne gjuhën shqipe, që të mund të komunikojnë e të punojnë më mirë në praktikë.
- Gjetja e mundësive për të futur në planin mësimor të lëndës "Konstruksione Arkitektonike" në vitin e parë.

### c. Mundësitë:

- Numri i madh i studentëve të Universitetit EPOKA, që mund të studiojnë në SHBA, Europë dhe në universitetet e shteteve të tjera të zhvilluara
- Angazhimi i autoriteteve të Universitetit Epoka për të siguruar mbështetje dhe lehtësira për studentët dhe stafin që largohet dhe vjen
- Rritja graduale e numrit të programeve të ofruara nga universiteti
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese
- Implementimi i lëvizjes së lirë të stafit dhe studentëve, përmes përfshirjes në programet e BE-së Erasmus + dhe Horizon 2020
- Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet e tjera

- Rritja e vetëdijes së stafit dhe studentëve për rëndësinë e sigurisë së cilësisë
- Përmirësimi i imazhit të Universitetit me orientim drejt kërkimit
- Lidhja ndërmjet kurrikulave, kompetencave të fituara nga studentët dhe kërkesës së tregut
- Zhvillimi i infrastrukturës së të mësuarit on-line

Në pikat e Mundësive të dhëna më sipër mendoj se klasifikimi i kryer sipas GVB është i drejtë dhe shumë i detajuar. Por mendoj se duhet shtuar edhe:

- Hapja e kurseve të formimit si një traditë e përhershme, që siguron lidhjen e praktikës me akademikët, ngritjen e nivelit të prakticienëve dhe të ardhura për IAL;

#### **d. Pengesat /Kërcënimet:**

- Rritja e globalizimit e shoqëruar me rritje të konkurrencës në tregjet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë
- Ndikimi i krizës financiare globale në burimet financiare të publikut të gjerë dhe universitetit
- Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë
- Numri i lartë i universiteteve në Shqipëri
- Të dhënat joreale të sektorit të arsimit në Shqipëri
- Mungesa e një rankimi objektiv të universiteteve në rajon dhe në vend
- Konkurenca jo e drejtë në sektorin e arsimit të lartë në Shqipëri
- Niveli i lartë i papunësisë si dhe mungesa e fondeve për kërkim dhe zhvillim i sipërmarrjeve shqiptare
- Subjektivizmi në rekrutimin e të diplomuarve

Në pikat e Pengesave të dhëna më sipër mendoj se klasifikimi i kryer sipas GVB është i drejtë dhe shumë i detajuar. Por mendoj se duhet shtuar edhe:

- Mangësitë në formimin e nxënësve të shkollave të mesme në shkencat fundamentale teorike si matematika, fizika dhe kimia.

#### **REKOMANDIME**

- 1) Të shihet mundësia e vendosjes së lëndës Konstruksione Arkitektonike me 3 ECTS, duke marrë kredite nga Gjuha Angleze që ka 11 ECTS
- 2) Të ketë një dokument ku shkruhen qartë fushat ku mund të punojë, dhe në çfarë pozicionesh mund të punojë specialisti “Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi”.
- 3) Të shihet mundësia e rishpërndarjes së ngarkesës së vitit të tretë, pasi ajo është shumë e madhe dhe krijon vështirësi në asimilimin e lëndëve si Konstruksione b/a. Gjeoteknikë, Themele, Rrugë etj. nga ana e studentëve.



4) Mendoj se mund të sigurojë të ardhura nga :

- Përfitimi i projekteve nga programet e ndryshme Europiane
- Projektet që realizohen për pushtetin vendor dhe qendror
- Puna për të tretët (në laborator).

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

Prof. Dr. Luljeta Bozo

